



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 59/2021 regjistri (JR)  
Datë 18.10.2021

Nr. 49 i vendimit  
Datë 09.11.2023

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 09.11.2023, ditën e enjte, ora 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Arben Smaçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 425, datë 21.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë.

## **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 425, datë 21.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Smaçi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave<sup>1</sup> (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

#### **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 425, datë 21.07.2021, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Smaçi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*
4. Komisioni përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Arben Smaçi nuk arrin nivelin kualifikues për sa i takon kriterit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

#### **III. Shkaqet e ankimit**

5. Kundër vendimit nr. 425, datë 21.07.2021, të Komisionit, ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), subjekti i rivlerësimit, në zbatim të nenit 63, pika 2, nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar nga Kolegji:

---

<sup>1</sup> ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.07.2018, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Arben Smaçi.

5.1. *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 425, datë 21.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Arben Smaçi.*

5.2. *Shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave, duke dëgjuar subjektin në seancë publike.*

5.3. *Ndryshimin e vendimit nr. 425, datë 21.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Smaçi.*

**6. Lidhur me shkaqet e ankimit me natyrë procedurale, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se:**

6.1. Vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar dhe paracaktuar, pasi ka përfunduar hetimin administrativ bazuar vetëm në një kriter, duke mos hetuar për kriterin e figurës dhe atë profesional.

6.2. Komisioni, duke mos marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, ka arritur në konkluzion të gabuar, duke krijuar dyshimin për shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

6.3. Mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë mund të përbëjë “deklarim të pamjaftueshëm”, në kuptim të nenit 61, pika 3, vetëm nëse është në atë nivel të rëndë shkeljeje, të krahasueshëm ose të barabartë me fshehjen e pasurisë ose situatën e konfliktit të interesit.

6.4. Komisioni, duke mos marrë në konsideratë konkluzionin e një organi të specializuar si ILDKPKI-ja, ka interpretuar fakte qëllimisht në mënyrë të gabuar, duke arritur në konkluzione të pavërteta dhe në kundërshtim me ligjin.

6.5. Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.

6.6. Komisioni në vendime të ndryshme të tij ka mbajtur standarde të dyfishta në interpretimin dhe kuptimin e nenit D të Kushtetutës, lidhur me deklaratimet e pasakta ndër vite.

**7. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.**

7.1. *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 123,3 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekti pretendon se shuma e paguar për blerjen e këtij apartamenti, është ajo e përcaktuar në kontratën premtim blerje, në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, paguar shitësit, z. Xh. B..*

7.1/a Lidhur me çmimin prej 90.000 (nëntëdhjetë mijë) eurosh, të vendosur në kontratën e sipërmarrjes për prentim apartamenti midis palës shitëse, “{\*\*\*}” ShPK, dhe palës blerëse, z. Xh. B., subjekti pretendon se gjithë kjo shumë është paguar nga z. Xh. B..

7.1/b. Subjekti pretendon se nuk ka ekzistuar asnjë marrëdhënie juridike e tij me kompaninë “{\*\*\*}” ShPK, por vetëm me shtetasin Xh. B. që rezultonte të ishte pronar i këtij apartamenti, si dhe nuk ka kryer asnjë pagesë në favor të kësaj kompanie, ndërsa shitësit, z. Xh. B., i ka paguar vetëm shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh, të deklaruar në vitin 2015, nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare, në momentin e nënshkrimit të kontratës.

7.1/c. Subjekti pretendon se ka depozituar në Komision mandatpagesa për depozitimet në *cash* dhe transferta të brendshme, si dhe kopje të dokumenteve të identifikimit që janë përdorur për të bërë veprimet bankare pranë Union Bank, me qëllim blerjen e apartamentit me sipërfaqe 123,3 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, por Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë, si dhe nuk ka arsyetuar/vlerësuar lidhur me mospagimin e këtyre pagesave nga ana e tij.

7.1/ç. Subjekti kundërshton referimin e Komisionit për përcaktimin e çmimit të blerjes së apartamentit në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 30.09.2015, pasi ky udhëzim ka hyrë në fuqi më datë 30.09.2015, ndërsa ai e kishte blerë apartamentin sipas kontratës premtim shitje të datës 15.05.2015.

7.1/d. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të pabazë dhe të pasaktë qëndrimin e Komisionit mbi deklarimin e rremë të çmimit të blerjes së apartamentit, në një kohë që nuk e konsideron fshehje të të ardhurave pagesën prej 40.000 (dyzet mijë) eurosh, të pretenduar si pjesa tjetër e çmimit të këtij apartamenti, si dhe kur të gjitha kontratat e lidhura për këtë pasuri nga ana e tij, janë të kryera në formën e duhur të kërkuar nga ligji, certifikuar para noterit dhe regjistruar pranë zyrave vendore të ASHK-së.

7.2. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni është kontradiktor në qëndrimet e tij pasi, huanë e marrë nga shtetasi N. F., në shumën prej 20.000 (njëzet mijë) eurosh, megjithëse e konsideron si të ardhur nga një burim i ligjshëm, nuk e konsideron për pagimin e kësteve të çmimit të apartamentit.

7.3. Lidhur me të ardhurat e sjella nga vëllai i tij P. S., si emigrant në Mbretërinë e Bashkuar, subjekti pretendon se i ka të dokumentuara nëpërmjet akteve shkresore me fuqi të plotë provuese, duke i deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.

7.4. Lidhur me shpenzimet e jetesës, subjekti pretendon se deri në shtator të vitit 2016, ka jetuar me prindërit dhe vëllezërit e tij dhe shpenzimet e tij kanë qenë të papërfillshme, pasi pjesën më të madhe të tyre e mbulonin prindërit dhe vëllezërit.

Subjekti e konsideron absurde llogaritjen e shpenzimeve për jetesë nga Komisioni për vitet 2016 dhe 2017, pasi për vitin 2016 i ka llogaritur ato në shumën 393.251 lekë, ndërsa për vitin 2017 në vlerën 940.368 lekë.

7.5. Subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit se ai nuk ka pasur mundësi për krijimin e depozitës në BKT, në vlerën prej 200.000 lekësh në vitin 2008, pasi duke jetuar në fshat së bashku me prindërit dhe vëllezërit, ka qenë pjesë e familjes bujqësore dhe përveç të ardhurave bujqësore, ka përfituar edhe të ardhura nga puna si jurist në Bashkinë Dibër.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### **A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit**

###### **a) Juridiksioni i Kolegjit**

Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Arben Smaçi, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### **b) Legjitimimi i ankuesit**

Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>2</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### **c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit**

Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjyqimitin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

Nëpërmjet ankimit të datës 24.09.2021 dhe parashtrimeve të datës 03.11.2023, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar kalimin për gjykim të çështjes në seancë gjyqësore publike, shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave dhe ndryshimin e vendimit nr. 425, datë 21.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Sa u takon akteve shkresore që subjekti i ka sjellë me parashtrimet e datës 03.11.2023, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të neneve 47 dhe 49 të ligjit nr. 49/2012, të cilat përcaktojnë si kohë të paraqitjes së provave të reja, momentin e depozitimit të ankimit, fakt që duhet të ekzistojë së bashku me kriteret që parashikojnë këto dispozita. Pavarësisht se rezulton që subjekti këto akte i ka paraqitur me parashtrimet, në zbatim të nenit

---

<sup>2</sup> Vendimi i arsyetuar i Komisionit nr. 425, datë 21.07.2021, për rivlerësimin e subjektit Arben Smaçi, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit dorazi, më datë 14.09.2021, kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 24.09.2021, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit nr. {\*\*\*}, datë 24.09.2021, që rezulton të jetë dita e 10-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit Arben Smaçi e ka dorëzuar ankimin e tij në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

49 të ligjit nr. 49/2012, pra në tejkallim të afatit kohor të parashikuar prej ligjit, trupi gjykues sërish i vlerësoi ato në kuptim të nenit 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, në harmoni me parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në analizë të të cilave konkludoi se marrja e provës duket se është e panevojshme.

Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi se aktet e dorëzuara në Kolegj, bashkëlidhur parashtrimeve me shkrim të subjektit të rivlerësimit, përveç se nuk përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja, referuar dispozitave të sipërcituara ligjore, por edhe u konsideruan pa efekt mbi vendimmarrjen e trupit gjykues për zgjidhjen e çështjes dhe, për rrjedhojë, nuk u administruan në cilësinë e provës në këtë gjykim. Për të përcaktuar formën e gjykimit në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi të shqyrtonte në mënyrë të integruar pretendimet e ngritura lidhur me shkeljet procedurale nga subjekti i rivlerësimit.

## **B. Vlerësimi lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit**

8. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar dhe paracaktuar, pasi ka përfunduar hetimin administrativ bazuar vetëm në një kriter, duke mos hetuar për kriterin e figurës dhe atë profesional. Mosplotësimi i njërit kusht kur në ligj ato janë kumulative, bën që konkluzioni i Komisionit, duke u bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të jetë haptazi i pambështetur në ligj, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, referuar standardeve të GjEDNj-së.*

8.1. Pretendimin e mësipërm të subjektit të rivlerësimit, Kolegji e vlerëson të pabazuar, pasi nga verifikimi i procedurave të ndjekura nga Komisioni, konstatoi se me vendimin e tij nr. 1, datë 15.01.2021, ka vendosur të fillojë hetimin administrativ duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, ndërsa me vendimin nr. 2, datë 18.06.2021, ka vendosur: *Të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Arben Smaçi, vetëm për kriterin e pasurisë*, bazuar në relacionin “Mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Arben Smaçi”. Për sa më sipër, Kolegji vëren se në rastin konkret, Komisioni ka nisur procedurën e hetimit administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit dhe në vijim ka arritur në konkluzionin se provat e administruara gjatë hetimit administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kanë pasur nivelin e provueshmërisë sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar se subjektit të rivlerësimit mund t’i kalonte barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ. Një situatë e tillë procedurale çmohet nga Kolegji se nuk bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi dhe nuk demonstroi as paragjykim të trupës gjyquese të Komisionit apo paracaktim të vendimit.

8.1.1. Nenet D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës qartësisht zërthejnë procesin e rivlerësimit në kriteret e cilat edhe veçmas mund të sjellin pasojë shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit. Më tej, në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, ligjvënësi ka çmuar se është në interesin publik shqyrtimi i çështjes brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm dhe, për këtë arsye, ka ligjëruar përfundimin bazuar vetëm në një kriter, kur rezultatet e hetimit për kriterin përkatës janë të mjaftueshme për të mbështetur vendimmarrjen.

**8.1.2.** Në referim të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, që parashikon se: *Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi*, interpretuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>3</sup>, rezulton që procesi i rivlerësimit nuk ka për qëllim të verifikojë detyrimisht të tria kriteret e vlerësimit për subjektet e rivlerësimit, si një proces që përcakton standardin e tyre në përmbushje të detyrës apo gradën e vlerësimit të tyre. Kushtetuta dhe ligji kërkojnë që ky proces të zhvillohet në funksion të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe të garantimit të funksionimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kontekst të qëllimit të Kushtetutës, nuk do të merrte vlerë dhe qëllim të ligjshëm konstatimi i Komisionit për rivlerësimin e kritereve të tjera, për sa kohë arrihet në konkluzionin se në verifikim edhe të një kriteri, një subjekt rivlerësimi do të duhet të largohet nga sistemi i drejtësisë me qëllim rikthimin e besimit të publikut te drejtësia.

**8.2.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *Komisioni, duke mos marrë në konsideratë provat e paraqitura gjatë hetimit administrativ, ka arritur në konkluzion të gabuar, kontradiktor dhe të pasaktë në drejtimin ligjor dhe ekonomik, veprime këto të cilat krijojnë dyshimin për shkelje të parimit të gjyqimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, Kolegji, pasi analizoi aktet e fashikullit të Komisionit lidhur me këtë çështje, e vlerëson të pabazuar këtë pretendim, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit, më datë 28.6.2021, ka paraqitur një kërkesë përmes postës elektronike, nëpërmjet së cilës kërkoi zgjatjen e afatit të përcaktuar nga Komisioni për dorëzimin e shpjegimeve dhe provave, për shkak të pamundësisë objektive për të siguruar brenda afatit gjithë dokumentacionin e kërkuar. Me vendimin nr. 3, datë 29.6.2021, Komisioni vendosi të shtyjë afatin për dërgimin e përgjigjeve deri në datën 07.07.2021. Subjekti i rivlerësimit në datën 07.07.2021, përmes postës elektronike, ka dërguar dokumente dhe prova shkresore në funksion të rezultateve të hetimit.

**8.2.1.** Më konkretisht, Komisioni rezulton se ka administruar në cilësinë e provës aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, lëvizjet e llogarive bankare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, që vërtetojnë transferim dividendi në favor të z. Xh. B., deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 13.04.2021, të këtij shtetasi, deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 25.05.2015, të shtetasit N. F. për huanë e marrë nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, në seancën dëgjimore të datës 15.07.2021, subjekti paraqiti dy mandatpagesa të nënshkruara pranë Union Bank nga z. Xh. B.. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, Kolegji vëren se Komisioni ka marrë qëndrime për çështje të caktuara mbi argumentin se subjekti nuk ka mundur të provojë me provat e paraqitura, që ka një nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, çka dëshmon në vetvete se provat e paraqitura prej tij i janë nënshtruar një procesi analize e vlerësimi në përputhje me bindjen e brendshme të trupës gjykuese në Komision.

**8.2.2.** Fakti që ky vlerësim i provave nga Komisioni është i ndryshëm nga pritshmëritë dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nuk tregon se ka munguar vlerësimi i tyre, por tregon se provat e sjella, pasi janë shqyrtuar nga Komisioni, në këndvështrimin e tij, nuk kanë mundur të

---

<sup>3</sup> Shih vendimet e Kolegjit: nr. 6/2018 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. B. N.; nr. 1/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. A. L.; nr. 15/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, z. D. Rr..

provojnë faktin për të cilin janë paraqitur, dhe ky vlerësim është një pushtet diskrecional i Komisionit, në përputhje me atributet gjyquese e vlerësuese që ky organ ka në këtë proces, sipas parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, Kolegji vlerëson se procedura e ndjekur nga ana e Komisionit në trajtimin e kërkesave të subjektit për marrjen e provave, rezultoi të jetë kryer në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk u konstatuan shkelje të natyrës procedurale, të cilat mund të përbënin cenim të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor.

**8.3.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë mund të përbëjë “deklarim të pamjaftueshëm”, në kuptim të nenit 61, pika 3, vetëm nëse është në atë nivel të rëndë shkeljeje, të krahasueshëm ose të barabartë me fshehjen e pasurisë ose situatën e konfliktit të interesit*, trupi gjyqës sjell në vëmendje se jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit në drejtim të interpretimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tilla të subjekteve të rivlerësimit, si të pabazuara në ligj.

Për sa kohë përcaktimet e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport me njëra-tjetrën, por shihen si të pavarura, vlerësimi i tyre në kuadër të prodhimit të pasojave të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u nënshtrohet rast pas rasti parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit për secilën prej tyre.

**8.4.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni nuk ka marrë në konsideratë konkluzionin e një organi të specializuar si ILDKPKI-ja, si dhe fakti që ky institucion nuk ka marrë asnjë masë ndër vite ndaj subjektit të rivlerësimit, provon se konkluzionet e Komisionit janë të pavërteta, në kundërshtim me ligjin dhe bazohen në fakte të interpretuara qëllimisht në mënyrë të gabuar*, Kolegji, pasi analizoi vendimin objekt shqyrtimi, konstatoi se Komisioni ka shtjelluar në faqet 3 - 4 të vendimit, hetimet e pavarura të kryera në funksion të procesit të rivlerësimit, përfshirë edhe analizën e raportin e dorëzuar nga ILDKPKI-ja, deklaratën e pasurisë *vetting* dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite, provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, provat shkresore të administruara në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 nga institucionet qendrore shtetërore, bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore dhe drejtoritë rajonale, institucionet dhe entet publike, zyra noteriale etj., deklaratimet, provat, shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore. Vlera dhe vendi që zë raporti i kontrollit të kryer nga ana e ILDKPKI-së në raport me vlerësimin përfundimtar të procesit të rivlerësimit të kryer nga institucionet e rivlerësimit, është elaboruar gjerësisht nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit kontrollin e plotë të procesit të rivlerësimit e kanë organet e rivlerësimit. Referuar këtij vendimi dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, bazuar edhe në hetimin administrativ që zhvillon ai vetë, dhe nuk është i kushtëzuar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse. Për sa më lart, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

**8.5.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 1, duke qenë se ai nuk ndodhet në*



*kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, në kundërshtim edhe me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë ligjore kjo që kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, Kolegji vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe jorelevant për shqyrtim në raport me zgjidhjen e çështjes, sa kohë Komisioni nuk e ka përdorur këtë situatë ligjore si një shkak për shkarkimin e subjektit, por ka konkluduar për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, duke e kualifikuar situatën sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Tashmë ka një qëndrim të konsoliduar të organeve të rivlerësimit për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vlerësimi për secilin kriter rivlerësimi (atë të pasurisë dhe pastërtisë së figurës) është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

**8.5.1.** Nga ana tjetër, neni 59 i ligjit nr. 84/2016, në pikën 1 parashikon se për konfirmimin në detyrë, duhet që subjekti të rezultojë se përmbush të tria kriteret dhe, si i tillë, arrin të ketë në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Fakti që neni 59 i ligjit nr. 84/2016, me qëllim konfirmimin në detyrë, kërkon domosdoshmërisht vlerësimin pozitiv të të tria kritereve së bashku, nuk ndalon Komisionin që në rastet kur rezulton se nga hetimet e kryera, për një apo dy kritere, një subjekt nuk arrin një nivel të besueshëm, të mund të përfundojë rivlerësimin duke e bazuar edhe në një kriter. Ky qëndrim vjen edhe në funksion të moszgjatjes së procesit të rivlerësimit me hetime dhe rivlerësime për kritere që edhe nëse rezultojnë me nivel kualifikues (referuar dy kritereve të tjera), nuk ndryshojnë rezultatin mbi procesin e rivlerësimit të subjektit.

**8.5.2.** Kolegji ka krijuar jurisprudencë të konsoliduar<sup>4</sup> në rastet kur deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kriterin objekt shqyrtimi, vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe, si i tillë, ai nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e bazueshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.

**8.6.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni në vendime të ndryshme të tij ka mbajtur standarde të dyfishta në interpretimin dhe kuptimin e nenit D të Kushtetutës, lidhur me deklaratimet e pasakta ndër vite*, Kolegji vlerëson se mbajtja e standardeve të ndryshme nga Komisioni në situata të ngjashme, nuk mund të përbëjë a priori shkak procedural për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kritereve të rivlerësimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje të mëparshme të tij<sup>5</sup>.

---

<sup>4</sup> *Shih vendimet e Kolegjit nr. 9 (JR), datë 24.10.2018; nr. 7 (JR), datë 05.04.2019; nr. 28 (JR), datë 30.10.2019 etj.*

<sup>5</sup> *Shih vendimin e Kolegjit nr. 7 (JR), datë 05.04.2019.*

8.7. Në konkluzion të arsytimit të mësipërm lidhur me shkaqet e ankimit që adresohen ndaj shkeljeve procedurale, Kolegji vlerësoi se nuk rezultojnë rrethana që tregojnë se vendimi nr. 425, datë 21.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të jetë bazuar në shkelje të rënda procedurale apo gjendje faktike të konstatuar gabim, si shkaqe që justifikojnë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, sipas parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012. Për pasojë, çështja u gjykua në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi sipas parashikimit të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

### **C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

#### **9. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 123,3 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë**

9.1. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti:

(i) nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës sa i takon çmimit të blerjes së pasurisë apartament banimi në Tiranë dhe krijoi bindjen se çmimi i paguar nga subjekti për blerjen e saj, është në vlerën 90.000 euro, aq sa shitësi i parë i pasurisë e kishte blerë pasurinë në të njëjtën datë që ka lidhur kontratën për premtimin e shitjes me subjektin dhe po aq sa janë shitur 11 apartamente të tjera në të njëjtin pallat. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të rremë të çmimit të blerjes së këtij apartamenti në DPV-në e vitit 2015 dhe në deklaratën “vetting” (germa “a” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016);

(ii) nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme shumën 50.000 euro, paguar deri më 08.06.2015, për shkak të një balance negative prej - 4.011.101 lekësh, rezultuar nga analiza financiare deri në këtë datë, si dhe ka qenë në pamundësi financiare për të paguar diferencën prej 40.000 eurosh, për shkak të një balance negative prej -6.545.522 lekësh (germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016).

Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm të pasurisë objekt shqyrtimi, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili e parashikon këtë si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

9.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit, për sa i takon çmimit të shitjes së pasurisë në vlerën prej 90.000 eurosh, nuk është i bazuar në prova, pasi sipas tij, *shuma e paguar për blerjen e këtij apartamenti, është ajo e përcaktuar në kontratën premtim blerjeje, në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, paguar shitësit, z. Xh. B..*

9.2/a. Lidhur me çmimin prej 90.000 (nëntëdhjetë mijë) eurosh, të vendosur në kontratën e sipërmarrjes për prentim apartamenti midis palës shitëse, “{\*\*\*}” ShPK, dhe palës blerëse, z. Xh. B., subjekti pretendon se Komisioni nuk ka administruar asnjë akt shkresor që të vërtetojë pagesa të kryera prej tij në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, dhe se të gjitha pagesat janë kryer prej z. Xh. B..

9.2/b Subjekti pretendon se nuk ka ekzistuar asnjë marrëdhënie juridike e tij me kompaninë “{\*\*\*}” ShPK, por vetëm me z. Xh. B. që rezultonte të ishte pronar i këtij apartamenti, si dhe

nuk ka kryer asnjë pagesë në favor të kësaj kompanie, ndërsa shitësit, z. Xh. B., i ka paguar vetëm shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh, të deklaruar në vitin 2015, nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare në momentin e nënshkrimit të kontratës.

**9.2/c** Subjekti pretendon se ka depozituar në Komision mandatpagesa për depozitimet në *cash*, transfertat e brendshme, si dhe kopje të dokumenteve të identifikimit që janë përdorur për të bërë këto veprime bankare pranë Bankës Union, me qëllim blerjen e apartamentit me sipërfaqe 123,3 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, por Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë, si dhe nuk ka arsyetuar/vlerësuar qëndrimin e tij lidhur me këto pagesa.

**9.3.** Me qëllim shqyrtimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, Kolegji çmoi të marrë në analizë fillimisht përcaktimin e çmimit të vendosur në kontratat respektive, mënyrën e likuidimit të çmimit, si dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim “AShK”), me shkresën kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 05.02.2021, ka informuar Komisionin se figuron e regjistruar në bashkëpronësi të z. Arben Smaçi dhe znj. E. S., pasuria nr. {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, e llojit apartament me sip 111,5 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga “{\*\*\*}”, Shk. {\*\*\*}, K. {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}, Tiranë, pasuri e cila, sipas të dhënave të kartelës së pasurisë, është regjistruar në pronësi të tyre më datë 27.07.2020.

#### **9.4. Në lidhje me çmimin e përcaktuar në kontratat e sipërmarrjes dhe shitjes**

**9.4/a.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ<sup>6</sup>, rezulton se lidhur me këtë pasuri, janë kryer veprimet juridike të mëposhtme.

Me kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.05.2015, pala investitore shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, ka marrë përsipër të ndërtojë për shtetasin Xh. B. apartamentin numër {\*\*\*}, me sipërfaqe të përgjithshme 123,3 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe individuale 111,5 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 11,8 m<sup>2</sup>, ndodhur në katin e dytë të banimit në kompleksin “{\*\*\*}”, struktura BB, 4, 8, 9 kate banimi. Çmimi i përgjithshëm i shitjes së apartamentit me nr. {\*\*\*}, është caktuar 90.000 euro, i cili do të paguhet me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes në llogaritë bankare të përcaktuara nga sipërmarrësi.

Në të njëjtën ditë dhe menjëherë pas aktit të sipërpërmendur, është lidhur kontrata për premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.05.2015, midis palëve: premtues shitës Xh. B. e bashkëshortja e tij L. B.; premtues blerës Arben Smaçi dhe pëlqim dhënës shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, sipas së cilës premtuesi shitës i premtton premtuesit blerës kalimin e të drejtave të pronësisë mbi apartamentin e banimit të lartpërmendur numër {\*\*\*}, kundrejt çmimit 50.000 euro. Në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2015, subjekti e ka deklaruar këtë kontratë me të njëjtën vlerë dhe të njëjtin burim të deklaruar në deklaratën *vetting*.

Me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.07.2020, pala shitëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK (të dyja të përfaqësuara nga zoti F. B.) i kanë shitur blerësit Arben Smaçi, pasurinë e paluajtshme nr. {\*\*\*}, sipërfaqe 111,5 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e përbashkët 11,8 m<sup>2</sup>, ZK {\*\*\*}, në adresën: rruga “{\*\*\*}”, Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}, Tiranë. Në

---

<sup>6</sup> Shih aktet në aneksin nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së; dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 05.02.2021, nga ASHK Tirana Jug dhe dokumentet e dërguara në rrugë elektronike më datë 17.06.2021, nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në dosjen e Komisionit.

nenin 3 të kësaj kontrate, “Çmimi i shitjes dhe mënyra pagesës”, është parashikuar se: sipas kontratës së sipërmarrjes (për prenotim apartamenti) me nr. rep./kol. {\*\*\*}, datë 15.05.2015, pala shitëse është shlyer për çmimin e përgjithshëm të shitjes prej 90.000 eurosh nga Xh. B. (porositësi) dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me këtë shumë. Ndërsa Arben Smaçi (blerësi/premtuesi blerës), sipas kontratës së premtim shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.05.2015, ka shlyer shtetasin Xh. B. (premtuesi shitës) vlerën totale prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh.

**9.4.b.** Subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, duke pretenduar se: *Këtë apartament, z. Xh. B. e kishte përfutur si dividend në kompaninë {\*\*\*} ShPK, ku ai ka qenë aksioner. Në pamundësi të pagesës së dividendit nga shoqëria ndaj aksionerit Xh. B., është rënë dakord që t'i jepej një apartament që ta shiste, dhe çmimi i caktuar të ishte vlera e dividendit që ai do të përfitonte nga kompania si çmim reference në raport me të gjithë aksionerët e tjerë dhe pronarët e truallit. Sipas subjektit, shuma prej 90.000 eurosh nuk ishte paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës, por nga viti 2016 e në vazhdim, kur nga shoqëria {\*\*\*} ShPK ishin shpërndarë dividendët e vitit 2015. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti ka paraqitur në Komision deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 13.04.2021, të z. Xh. B., i cili ka konfirmuar<sup>7</sup> deklaratimet e subjektit.*

**9.4.c.** Nga analizimi i kontratave të sipërcituara, rezulton se ato janë të hartuara në të njëjtën ditë, para të njëjtit noter, madje njëra pas tjetrës, sipas numrit rendor të radhës së regjistruar në regjistrin noterial. Kolegji vëren se ekziston një diferencë e madhe dhe e konsiderueshme e vlerës së çmimit të blerjes së kësaj pasurie në raport me çmimin e shitjes së saj (pagesa e blerësit të parë, z. Xh. B., është 90.000 euro, ndërsa vlera e paguar nga subjekti i rivlerësimit si blerës i dytë, te po ky shtetas, është 50.000 euro).

Nga shqyrtimi i dosjes së Komisionit, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur dokumentacion (marrëveshje, kontratë) që të vërtetonte pretendimin për konvertimin e dividendit në pasuri të paluajtshme nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, te z. Xh. B.. Pretendimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit bëhen akoma më të pabesueshme në kushtet kur nga shitja e këtij apartamenti, duket se shitësi, z. Xh. B., jo vetëm ka munguar të realizojë një fitim prej 40.000 eurosh, duke konsideruar vlerën në treg të apartamentit, por ai ka pësuar një humbje në këtë vlerë, duke qenë se në mënyrë të pashpjegueshme ia ka paguar atë shoqërisë në vijim,

---

<sup>7</sup> Shtetasi Xh. B. deklaroi se: “[...] Vendosi e çmimit prej 90.000 eurosh është bërë duke respektuar metrin katrorë të sipërfaqeve përfutuese të pronarëve të truallit, ndarje raportesh mes ortakëve dhe si çmim reference midis të gjithë pronarëve të truallit ku është ndërtuar ky kompleks banimi... Në vitet më pas kur më janë kryer pagesa nga dividendi i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nga pjesa që kam përfutur prej tyre, kam bërë edhe shlyerjen e kontratës në vlerën 90.000 euro... Meqenëse në atë kohë unë me subjektin “{\*\*\*}” ishim në marrëdhënie kontraktore dhe si pronar truallit në ndërtimet që kryheshin, por edhe si investitor, i jam drejtuar kompanisë për likuiditete. Në pamundësi për të përfutur nga dividendi, nga “{\*\*\*}” më është dhënë një apartament për ta shitur, konkretisht apartamenti në fjalë. Për këtë është lidhur kontrata e sipërmarrjes për prenotim apartamenti me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.05.2015, kjo krijonte një veshje juridike mes meje dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK si dhe më legjitimonte mua si posedues (pronar) për hyrjen në marrëdhënie të re kontraktore e kështu më pas është lidhur kontrata me z. Arben Smaçi”.

megjithëse nuk e kishte përfituar nga shitja dhe as në ndonjë formë tjetër si dividend, në kohën kur pretendon subjekti.

Gjithashtu konstatohet se një fakt tjetër që tregon vlerën reale të çmimit të blerjes së apartamentit, pasqyrohet në kartelën e pasurisë nr. {\*\*\*}, e regjistruar në emër të bashkëshortëve Smaçi në datën 27.7.2020, sipas së cilës vlera e pasurisë së shitur është shënuar 90.000 euro, duke e potencuar pabesueshmërinë në deklaratimet e subjektit se çmimi i shitjes së këtij apartamenti ka qenë vetëm në vlerën prej 50.000 eurosh.

**9.4/ç.** Pretendimin e subjektit se referimi i Komisionit në përcaktimin e çmimit të blerjes së apartamentit në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 30.09.2015, është i pasaktë, pasi ky udhëzim ka hyrë në fuqi më datë 30.09.2015, ndërsa ai e kishte blerë apartamentin sipas kontratës premtim shitje të datës 15.05.2015, Kolegji e vlerëson pa ndonjë efekt në përcaktimin e çmimit të blerjes së apartamentit, pasi edhe në rast se do të referohej në udhëzimin nr. 2, datë 6.8.2014, të Këshillit të Ministrave që ishte në fuqi në kohën e përpilimit të kontratës së sipërmarrjes, çmimi i referencës për metër katror për zonën e Tiranës ku ndodhet apartamenti i subjektit, është i njëjtë me atë të udhëzimit të përdorur nga Komisioni<sup>8</sup>.

Në këtë mënyrë, edhe nëse do të referohej në udhëzimin nr. 2, datë 6.8.2014, të Këshillit të Ministrave, çmimi i referencës për zonën 7/4 të qytetit të Tiranës, ku ndodhet apartamenti i subjektit të rivlerësimit, rezulton të jetë 65.000 lekë/m<sup>2</sup> dhe vlera e apartamentit sipas çmimeve të referencës, përsëri do të ishte 7.995.000 lekë (65.000 lekë/m<sup>2</sup> x 123 m<sup>2</sup>), në një kohë që subjekti pretendon se e ka blerë në vlerën prej 50.000 eurosh/6.864.000 lekë

Në këto kushte, Kolegji, ashtu si dhe Komisioni, konstaton se çmimi i blerjes së apartamentit është shumë më i ulët se çmimi i referencës i përcaktuar për atë zonë, konkretisht vlera e apartamentit sipas çmimeve të referencës është 1.131.000 lekë më e lartë se çmimi i deklaruar i shitjes.

**9.4/d.** Me qëllim krijimin e një tabloje sa më të qartë lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, Kolegji analizoi kontratat e ngjashme të administruara<sup>9</sup> gjatë hetimit administrativ në Komision, për apartamente të ndodhura në të njëjtin pallat, madje edhe në të njëjtin kat me apartamentin e blerë nga subjekti i rivlerësimit.

Nga analizimi i kontratave të ngjashme<sup>10</sup>, rezultoi se çmimet për m<sup>2</sup> të blerësve të të gjitha apartamenteve variojnë nga çmimi minimal 735 euro/m<sup>2</sup> në çmimin maksimal 816 euro/m<sup>2</sup>,

<sup>8</sup> Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 30.09.2015, çmimi i referencës për m<sup>2</sup> për zonën 7/4 të qytetit të Tiranës, rezulton të jetë 65.000 lekë për m<sup>2</sup>.

<sup>9</sup> Referuar dokumenteve të dërguara në rrugë elektronike nga shoqëria "{\*\*\*}" ShPK, më datë 17.06.2021 dhe datë 18.06.2021

<sup>10</sup> 1) Kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 5.5.2020, me palë blerëse E. L. etj., me objekt shitje apartamenti me sip. 54,9 m<sup>2</sup> (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}) me çmim 42.900 euro; 782 euro/m<sup>2</sup>; 2) kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 7.5.2020, me palë blerëse V. Ç. etj., me objekt shitje apartament me sip. 83,1 m<sup>2</sup>, (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}) me çmim 61.164 euro; 736 euro/m<sup>2</sup>; 3) kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.09.2020, me blerës V. K., me objekt shitblerje apartament me sip. 52,7 m<sup>2</sup> (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}), me çmim 42.486 euro; 806 euro/m<sup>2</sup>; 4) kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 5.5.2020, me blerës N. M., me objekt shitje apartament me sip. 80,3 m<sup>2</sup> (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}), me çmim 65.000 euro; 810 euro/m<sup>2</sup>; 5) kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.08.2020, me palë blerëse S. H., me sip. 80,3 m<sup>2</sup>, (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}), me çmim 65.000 euro; 810 euro/m<sup>2</sup>; 6) kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 1.5.2020, me palë blerëse P. D., me objekt shitje apartament me sip. 81,8 m<sup>2</sup> (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}) me çmim 64.000 euro; 782

ndërsa referuar çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes me të cilën është porositur apartamenti objekt kontrolli, rezulton se subjekti ka paguar çmimin prej afro 435 euro/m<sup>2</sup>. Për sa analizuar më lart, rezulton se çmimi prej 50.000 eurosh, deklaruar nga subjekti si çmim i blerjes së apartamentit, është sa pothuajse ½ e çmimit për m<sup>2</sup> të blerësve të tjerë në të njëjtin pallat.

#### **9.5. Lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes së përcaktuar në kontrata**

**9.5/a.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nuk ka ekzistuar asnjë marrëdhënie juridike mes tij dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, por vetëm mes tij dhe z. Xh. B., si dhe nuk ka kryer asnjë pagesë në favor të kësaj kompanie, por i ka paguar shitësit, z. Xh. B., vetëm shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh, të deklaruar në vitin 2015, Kolegji mori në analizë deklaratimet e subjektit, si dhe dokumentacionin financiar mbi kryerjen e pagesave për këtë pasuri, nga ku rezultoi se:

**9.5/b.** Subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2015, ka deklaruar: *Shlyerja e kontratës së blerjes së apartamentit nga shtetasi Xh. B.. Më datë 18.05.2015, i kam shlyer nëpërmjet Bankës BKT shtetasit Xh. B., shumën e 28.720 eurove.*

*Më datë 25.05.2015, i kam kaluar nëpërmjet BKT-së, shtetasit Xh. B. shumën prej 20.000 eurosh. Më datë 08.06.2015, i kam kaluar shtetasit Xh. B. nëpërmjet BKT-së, pjesën e fundit të shumës, vlerën 1.280 euro.*

Kontrata për premtim shitje e datës 15.05.2015, parashikon se me lidhjen e kontratës, çmimi prej 50.000 eurosh do të paguhet i plotë nga premtuesi blerës (subjekti) në llogarinë bankare të premtuesit shitës (Xh. B.). Sa i takon likuidimit faktik të kësaj shume, nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së<sup>11</sup> dhe nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë në BKT, ka rezultuar se subjekti ka kryer 3 (tri) transfertat/depozitime në Bankën BKT, në favor të z. Xh. B., për likuidimin e shumës në total prej 50.000 eurosh, si vijon:

**(i)** Më datë 18.05.2015, shuma 28.720 euro është depozituar *cash* në llogarinë e z. Xh. B. në BKT Bank, me përshkrimin: *Arben Smaçi derdhje në llogari për blerje apartamenti*. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare të subjektit, rezultoi se në këtë datë është tërhequr nga subjekti shuma prej 3.061.779 lekësh nga BKT-ja.

**(ii)** Më datë 25.05.2015, shuma prej 20.000 eurosh është transferuar nga llogaria e z. Arben Smaçi në llogarinë e z. Xh. B., me përshkrimin: *Blerje apartamenti në Tiranë*. Kjo shumë është

---

euro/m<sup>2</sup>; 7) kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 5.5.2020, me palë blerëse B. A., me objekt shitje apartament me sip. 82,1 m<sup>2</sup> (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}), me çmim 66.500 euro; 810 euro/m<sup>2</sup>; 8) kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.5.2020, me palë blerëse Gj. Gj., me objekt shitje apartament me sip. 81,2 m<sup>2</sup> (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}), me çmim 65.000 euro; 10.800 euro/m<sup>2</sup>; 9) kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.4.2020, me palë blerëse M. H. etj., me objekt shitje apartament me sip. 84,1 m<sup>2</sup> (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}) me çmim 68.620 euro; 816 euro/m<sup>2</sup>; 10) kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 7.5.2020, me palë blerëse V. J. etj., me objekt shitje apartament me sip. 81,8 m<sup>2</sup> (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}), me çmim 64.500 euro; 789 euro/m<sup>2</sup>; 11) kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.09.2020, me palë blerëse E. H. etj., me objekt shitje apartament me sip. 80,3 m<sup>2</sup> (Hyrja {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}), me çmim 64.000 euro; 797 euro/m<sup>2</sup>; 12) kontratë sipërmarrjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 7.2.2019, me palë blerëse Sh. K., me objekt shitje dy njësi shërbimi me sip. 118.8 m<sup>2</sup>, me çmim 125.000 euro; 1502 euro/m<sup>2</sup>.

<sup>11</sup> Shih aktet në aneksin 4/2 të dosjes të ILDKPKI-së.

transferuar në të njëjtën datë, nga llogaria e z. N. F. në llogarinë e Arben Smaçi, me përshkrimin: *Hua për shlyerje apartamenti Tiranë, në favor të Arben Smaçi.*

(iii) Më datë 08.06.2015, është depozituar në *cash* prej subjektit Arben Smaçi, në llogarinë e z. Xh. B. në BKT Bank, shuma 1.280 euro, me përshkrimin: *Arben Smaçi, derdhje në llogari për blerje apartamenti.*

**9.5/c** Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka dorëzuar në Komision:

- gjendjet e llogarisë bankare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ku pasqyroheshin pagesat në shumën totale prej 90.000 eurosh;

- deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 07.07.2021, të shtetasit Xh. B., i cili pohon të ketë paguar shumën prej 90.000 eurosh pranë Union Bank, nëpërmjet 13 pagesash, në kohë dhe sasi të ndryshme, në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Sipas këtyre deklarimeve, pagesat janë kryer prej tij ose nga persona të autorizuar prej tij dhe se në asnjë rast këto pagesa nuk janë kryer nga shtetasi Arben Smaçi, por, meqenëse pagesat kishin lidhje me të njëjtin apartament, në ndonjë rast në bankë është përmendur edhe emri i subjektit, për të bërë kështu të mundur identifikimin e apartamentit që i përkiste z. Smaçi;

- në seancën dëgjimore të datës 15.07.2021, dy mandatpagesa të nënshkuara pranë Union Bank, nga shtetasi Xh. B., përkatësisht mandatpagesa e datës 16.11.2016, në shumën prej 6.960 eurosh, me përshkrimin “Pagesë për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, ap. {\*\*\*}, objekti “{\*\*\*}” për Arben Smaçi”, si dhe mandatpagesa e datës 29.03.2017, në shumën prej 729.000 lekësh, me përshkrimin “Arben Smaçi për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, pagesë ap. {\*\*\*}, objekti “{\*\*\*}””. Në të dyja këto mandatpagesa rezulton se *klienti që kryen transaksionin*, është Xh. B. dhe nënshkrimi i tij, ndërsa në përshkrimin e tyre përmendet emri i subjektit Arben Smaçi.

**9.5/ç** Nga verifikimi i veprimeve bankare të kryera lidhur me likuidimin e çmimit të kësaj pasurie, nga ana e z. Xh. B., Kolegji konstaton se i gjithë çmimi prej 90.000 eurosh, i është paguar shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, gjatë viteve 2016 - 2019.

Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për moskryerje pagesash në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, si dhe deklaratimet e shtetasit Xh. B. u vlerësuan të pabesueshme nga Kolegji, në raport me faktet që kanë rezultuar nga provat e administruara dhe rrethanat e kryerjes së veprimeve bankare.

Referuar përshkrimeve të depozitimeve të kryera në llogarinë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, rezulton se subjekti ka kryer gjashtë pagesa, në shumën totale 34.690 euro, me përshkrim të qartë në to, lidhur me: destinacionin, shumën, përcaktimin e objektit (apartamentin e përfutur me kontratën për premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.05.2015) dhe cilësimin e emrit të subjektit të rivlerësimit, konkretisht siç pasqyrohen më poshtë.

1. Datë 07.11.2016, depozituar shuma 1.350 euro, me përshkrimin: “Pagesë për {\*\*\*} ShPK, Ap. {\*\*\*}, “{\*\*\*}”, Arben Smaçi”.
2. Datë 16.11.2016, depozituar shuma 6.960 euro, me përshkrimin: “Pagesë për {\*\*\*} ShPK, Ap. {\*\*\*}, “{\*\*\*}”, për Arben Smaçi”.
3. Datë 01.12.2016, depozituar shuma 7.000 euro, me përshkrimin: “Arben Smaçi për {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}, “{\*\*\*}””.
4. Datë 02.12.2016, depozituar shuma 7.000 euro, me përshkrimin: “Arben Smaçi për

- {\*\*\*}, pag. Ap. nr. {\*\*\*}, Obj. “{\*\*\*}””.
5. Datë 27.12.2016, depozituar shuma 7.000 euro, me përshkrimin: “Arben Smaçi për {\*\*\*} ShPK, pagesë Ap. {\*\*\*}, “{\*\*\*}””.
  6. Datë 29.03.2017, depozituar shuma 729.000 lekë/5.380 euro, me përshkrimin: “Arben Smaçi për {\*\*\*} ShPK, pag. Ap. {\*\*\*}, “{\*\*\*}”, dep. Xh. B.”.

Ndërsa z. Xh. B. ka kryer shtatë pagesa në shumën 55.310 euro:

1. datë 29.12.2016, depozituar shuma 7.000 euro, me përshkrimin: “Xh. B. për {\*\*\*}, pag. Ap. {\*\*\*}, Obj. “{\*\*\*}””;
2. datë 30.12.2016, depozituar shuma 7.000 euro, me përshkrimin: “Xh. B. për {\*\*\*}, pag. Ap. {\*\*\*}, Obj. “{\*\*\*}””;
3. datë 30.12.2016, depozituar shuma 7.000 euro, me përshkrimin: “Xh. B. për {\*\*\*} ShPK, pag. Ap. {\*\*\*}, Obj. “{\*\*\*}””;
4. datë 13.02.2017, depozituar shuma 7.000 euro, me përshkrimin: “Xh. B. pag. këst Ap. {\*\*\*}, “{\*\*\*}””;
5. datë 16.02.2017, depozituar shuma 7.000 euro, me përshkrimin: “Xh. B. për {\*\*\*}, pag. Ap. {\*\*\*}, Obj. “{\*\*\*}””;
6. datë 22.02.2017, depozituar shuma 531.200 lekë/3.935 euro, me përshkrimin: “Xh. B. për {\*\*\*} ShPK, pag. Ap. {\*\*\*}, “{\*\*\*}””;
7. datë 28.08.2019, depozituar shuma 16.375 euro, me përshkrimin: “Xh. H. B., kalim fondi për {\*\*\*} ShPK, pagesë Ap. {\*\*\*}, Obj. “{\*\*\*}””.

Nga sa më lart, Kolegji konstaton se nëpërmjet depozitimeve në Union Bank, subjekti ka paguar të paktën edhe 34.600 euro në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për llogari të blerjes së këtij apartamenti në periudhën 2016-2017. Kjo shumë do të duhet t’i shtohet shumës së paguar prej tij, në masën prej 50.000 euro, te z. Xh. B. (i cili e ka depozituar për shoqërinë në vitet 2016-2019), sërish për llogari të blerjes së këtij apartamenti. Nga këto të dhëna, rezulton se subjekti ka paguar nëpërmjet sistemit bankar shumën prej 84.690 eurosh për apartamentin, e cila është shumë më e lartë se shuma prej 50.000 eurosh, deklaruar si çmim në kontratën e porosisë dhe shumë më e afërt me shumën prej 90.000 eurosh, që është vlera e apartamentit sipas të gjitha akteve të analizuar më sipër. Ky fakt potencon sërish bindjen e Kolegjit se çmimi i blerjes së këtij apartamenti ka qenë në vlerën prej 90.000 eurosh. Pretendimi i subjektit se dokumentacioni bankar nuk provon që pagesat janë bërë prej tij, por vetëm përshkruan se për llogari të cilit apartament kanë shkuar ato, konsiderohet prej Kolegjit se mbetet i paprovuar dhe një mënyrë e leximit të këtij dokumentacioni bankar në abstragim të rrethanave të tjera të dala nga hetimi. Përshkrimet në dokumentacionin bankar, pavarësisht se nuk provojnë drejtpërdrejt pagimin e shumave nga subjekti i rivlerësimit, përfaqësojnë indicie të rëndësishme, të cilat, të analizuar së bashku me faktet e përshkruara më lart rreth çmimit të apartamentit, japin një tablo më të qartë rreth mënyrës së fitimit të pronësisë mbi këtë pasuri dhe vlerës së paguar për krijimin e saj. Në këtë logjikë, nëse kjo pjesë e çmimit nuk do të ishte paguar prej subjektit, por nga individë të tjerë apo vetë z. B., vlerësohet e pakuptimtë që në llogarinë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, të vendosej emri i subjektit, duke qenë se shoqëria nuk kishte në këto momente asnjë marrëdhënie me të, por kishte vetëm një kontratë porosie me z. B., identifikimi i të cilit, së bashku me pasurinë për të cilën kryheshin pagesat, do të mjaftonte për të përcaktuar kontratën



për llogari të së cilës shlyhej detyrimi. Për këtë arsye, mbetet i paprovuar dhe i pabesueshëm pretendimi se këto pagesa nuk i përkasin subjektit, ndërsa të analizuar në tërësinë e fakteve të tjera, krijojnë bindjen se janë kryer prej tij, në funksion të pagimit të çmimit real të blerjes së pasurisë.

**9.5/d** Për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me dy mandatpagesat e paraqitura në seancën dëgjimore, *se nisur nga fakti se këto shuma janë depozituar në bankë nga shtetasi Xh. B., duhet të konsiderohen si pagesë të këtij shtetasi*, Kolegji e vlerëson këtë fakt të pamjaftueshëm dhe të izoluar, në kushtet kur subjekti nuk rezulton të ketë depozituar në Komision gjatë hetimit administrativ, mandatpagesat për 11 veprimet e tjera bankare të kryera për këtë pasuri, në mënyrë që të lejonte kryerjen e një analize të detajuar të të dhënave të dokumentacionit bankar. Në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë kërkesën drejtuar Union Bank, të datës 24.06.2021, nëpërmjet së cilës kërkon t'i vihen në dispozicion kopje të të gjitha mandatpagesave për pagesat në *cash*, si dhe kopje të dokumenteve të identifikimit të personave që kanë kryer këto veprime për pagesat lidhur me apartamentin nr. {\*\*\*}, në objektin “{\*\*\*}”, në favor të kompanisë “{\*\*\*}” ShPK, por nuk rezulton që subjekti të ketë depozituar ndonjë përgjigje të marrë për këtë kërkesë nga Union Bank.

Në vlerësimin e Kolegjit, mungesa e përgjigjes nga Union Bank, e kushtëzuar nga paraqitja e një kërkesë të vonuar prej subjektit, vetëm në një fazë të avancuar të procesit, nuk e përjashton këtë të fundit nga përgjegjësia e tij për të provuar faktet që ai pretendon, se pagesat e përshkruara më lart, nuk janë kryer prej tij. Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për gjetjen e dokumentacionit justifikues ligjor për provueshmërinë e pagesave të kryera për pasurinë në pronësi të tij dhe të pretendimeve që ai ka në këtë proces në kuptim të parashikimit ligjor të neneve 51 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, që e ngarkon atë me barrën e provës për të provuar deklaratimet dhe faktet e pretenduara prej tij. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se subjekti nuk gjendet në këtë rast para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës ai përjashtohet nga përgjegjësia për të provuar pretendimet e tij për shkaqe objektive.

**9.5/dh** – Kolegji arrin në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit se çmimi i paguar prej subjektit për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 123,3 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, është në vlerën 90.000 euro, është i drejtë dhe i mbështetur në analizën e fakteve të renditura më lart, si: **(i)** çmimi i pretenduar nga subjekti është pothuajse sa ½ e vlerës se tregut për njëmbëdhjetë apartamente të shitura në të njëjtën godinë; **(ii)** vlera prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh, e vendosur në kontratën për premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.05.2015, është ndjeshëm më e ulët se çmimi i referencës i përcaktuar për atë zonë; **(iii)** përcaktimi i vlerës së apartamentit prej 90.000 eurosh në kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.07.2020, si e paguar nga z. Xh. B. te shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, ndonëse në të është përcaktuar se subjekti Arben Smaçi i ka shlyer shitësit vetëm vlerën prej 50.000 eurosh; **(iv)** vlera e pasurisë së shitur e përcaktuar në kartelën e pasurisë lëshuar nga ZRPPP, është në shumën 90.000 euro; **(v)** pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, të cilat tejkalojnë shumën prej 50.000 eurosh, të deklaruar se është paguar prej tij e të përcaktuar si çmim i shitjes së këtij apartamenti; **(vi)** mospasja e një logjike ekonomike në transaksionet e kryera nga z. Xh. B. me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe subjektin

e rivlerësimit, transaksione të cilat kanë prodhuar një humbje financiare në vlerën prej 40.000 eurosh, pa asnjë shpjegim të arsyeshëm dhe bindës për shkakun që e ka shkaktuar atë, në kushtet e një tregu që siguronte një transaksion me të paktën vlerën e blerjes së apartamentit nga shoqëria; **(vii)** pabazueshmërinë e pretendimeve të subjektit për përfitimin prej shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, si pjesë e dividendit për z. Xh. B., për sa kohë nuk provohet se ai e gëzonte cilësinë e ortakut të saj në periudhën e kryerjes së transaksionit, blerjes dhe pagesës së shumës prej 90.000 eurosh; **(viii)** mosdhënien e asnjë argumenti të arsyeshëm pse z. Xh. B. duhej t’ia shiste këtë apartament subjektit në vlerën prej 50.000 eurosh menjëherë sapo ai e kishte përfituar atë prej shoqërisë në vlerën prej 90.000 eurosh, të cilën do të duhej t’ia shlyente asaj sipas detyrimeve kontraktore<sup>12</sup>.

**9.5/e** Subjekti i rivlerësimit pretendon se *qëndrimi i Komisionit është i pasaktë dhe kontradiktor pasi në një kohë që nuk i konsideron fshehje të ardhurat për pagesën prej 40.000 (dyzet mijë) eurosh, të pretenduar si pjesa tjetër e çmimit të këtij apartamenti, konsideron deklarimin e rremë të çmimit të blerjes së apartamentit, kur të gjithë kontratat e lidhura për këtë pasuri nga ana e tij janë të kryera në formën e duhur, të kërkuar nga ligji.*

Lidhur me këtë pretendim, nga analizimi i vendimit të Komisionit, rezultoi se megjithëse ky i fundit i ka kaluar barrën e provës subjektit, duke e cilësuar si fshehje shumë prej 40.000 eurosh, të paguar si pjesë e çmimit për apartamentin, në përfundim ka vendosur të mos e kualifikojë mosdeklarimin e pagesës së kësaj shume si fshehje pasurie, pasi mori në konsideratë faktin se deklarata e pasurisë *vetting* është plotësuar në datën 28.01.2017 dhe një pjesë e pagesave që përbëjnë këtë shumë janë kryer pas kësaj date, gjithashtu blerja përfundimtare e pasurisë është bërë me akt noterial të vitit 2020 dhe objekt i veprimtarisë së Komisionit është rivlerësimi i pasurive të krijuara deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*. Për pasojë, ky pretendim i subjektit mbetet jorelevant dhe pa peshë në kontrollin e vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

**9.6.** Në vijim të analizës së mësipërme, Kolegji konstaton se Komisioni, ndonëse ka kaluar barrën e provës për deklarime të rreme të çmimit të blerjes së kësaj pasurie, si edhe ka arritur në përfundim në konkluzionin se çmimi i blerjes së pasurisë është në vlerën prej 90.000 eurosh dhe jo 50.000 euro, sa subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, e ka kualifikuar këtë situatë si deklarim të pasaktë, sipas parashikimit të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Kolegji, duke vlerësuar të gjitha faktet e arsyetuara më lart, për të cilat subjekti është mbrojtur dhe dëgjuar pas kalimit të barrës së provës, si edhe konkluzionin e arritur në përfundim të analizës logjike, bazuar në faktet e provuara gjatë hetimit dhe të arsyetuara nga Komisioni për konsiderimin e çmimit në vlerën prej 90.000 eurosh dhe vendosjen e subjektit para një deklarimi të pasaktë dhe të rremë<sup>13</sup>, e gjen të pasaktë qëndrimin e Komisionit në përfundim, lidhur me kualifikimin ligjor të kësaj situatë faktike, e cila duhet të kualifikohet

---

<sup>12</sup> Kontrata premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.05.2015, me premtues shitës Xh. B. e bashkëshortja e tij L. B.; premtues blerës Arben Smaci dhe pëlqimdhënës shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Kontrata e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.07.2020, pala shitëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe pala blerëse Arben Smaci.

<sup>13</sup> Paragrafët 43.1 dhe 45 të vendimit të Komisionit.

saktësisht me të drejtën e gjykatës për përcaktimin e saktë të fakteve<sup>14</sup>, sipas nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

**9.7.** Përfundimisht, Kolegji, në analizë të fakteve të evidentuara nga hetimi administrativ, arriti në konkluzionin se është i drejtë qëndrimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë të çmimit të blerjes së këtij apartamenti në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe se çmimi i blerjes së kësaj pasurie është vlera prej 90.000 eurosh, duke u gjendur në këtë mënyrë në situatën faktike që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

**9.8. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë sipas deklaramit në deklaratën *vetting*, rezulton se:**

**9.8/a.** Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë sqarime dhe prova për të vërtetuar të kundërtën e konstatimit se: (i) nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave të dërguara nga vëllai emigrant; (ii) nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e depozitave në BKT, të çelura në vitet 2008, 2014 dhe 2015; (iii) nuk ka pasur mundësi për të shlyer këstin e huasë shtetasit N. F., në shumën prej 5.000 eurosh në vitin 2016 dhe, për rrjedhojë, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për pagesën e çmimit të pretenduar prej 50.000 eurosh në vitin 2015, si dhe pagesën e shumës 40.000 euro gjatë viteve 2016 dhe 2017 (germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016).

**9.8/b.** Subjekti pretendon se të ardhurat e sjella nga vëllai i tij P. S. si emigrant në Mbretërinë e Bashkuar, i ka të dokumentuara nëpërmjet akteve shkresore me fuqi të plotë provuese, si dhe i ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.

Lidhur me shpenzimet e jetesës, subjekti pretendon se deri në shtator të vitit 2016, ka jetuar me prindërit dhe vëllezërit e tij dhe shpenzimet e tij kanë qenë të papërfillshme, pasi pjesën më të madhe të tyre e mbulonin prindërit dhe vëllezërit.

Subjekti e konsideron absurde llogaritjen e shpenzimeve për jetesë nga Komisioni për vitet 2016 dhe 2017, pasi për vitin 2016 i ka llogaritur ato në shumën 393.251 lekë, ndërsa për vitin 2017 në vlerën 940.368 lekë.

Subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit se ai nuk ka pasur mundësi për krijimin e depozitës në BKT, në vlerën prej 200.000 lekësh në vitin 2008, pasi duke jetuar në fshat së bashku me prindërit dhe vëllezërit, ka qenë pjesë e familjes bujqësore dhe, përveç të ardhurave bujqësore, ka përfituar edhe të ardhura nga puna si jurist në Bashkinë Dibër.

**9.8/c.** Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi dhe njëkohësisht kontrollit të vendimmarrjes së Komisionit lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie të subjektit të rivlerësimit, Kolegji mori në analizë deklaramet e subjektit dhe dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e Komisionit, nga ku rezultoi se:

Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Kontratë për premtim blerje apartamenti nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 123,3 m<sup>2</sup> në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në shumën 50.000 (pesëdhjetë) mijë euro. Pjesa takuese 100%.*

---

<sup>14</sup> Sipas parashikimit të nenit 16, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Civile.

*Burimi i krijimit: “Kjo pasuri është blerë mbi bazën e të ardhurave nga paga, kursimet e realizuara ndër vite gjatë punës sime dhe interesat bankarë, të ardhurat e sjella nga vëllai në Angli dhe gjatë kohës që ka qenë emigrant ilegal në Greqi, si dhe huaja e marrë në shumën e 20.000 eurove. Kjo shumë është shlyer e gjitha në vitin 2015.*

*Më datë 18.05.2015, kam tërhequr nga BKT-ja shumën e parave që i kisha lënë në depozitë bankare, kjo është bërë me qëllim shlyerjen e blerjes së apartamentit. Vlera 3.061.779 lekë. Pjesa takuese 100%. Kjo shumë e cila ishte depozitë, ka ardhur si rezultat i kursimeve të mia si prokuror, nga bursa ime si student i Magjistraturës, nga paga ime si jurist në Bashkinë Dibër dhe nga emigracioni nga vëllai im P. S. në Greqi.*

*Në deklaratën e pasurisë vetting, në rubrikën “Detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar: (i) kontratë huaje pa interes me shtetasin N. F., në shumën 20.000 euro, me afat 4 vjet, me këst shlyerjeje në shumën e 5.000 eurove/vit. Kjo hua është marrë për pagesën e kontratës së premtim blerjes së apartamentit në Tiranë. Shuma e detyrimit të mbetur 15.000 euro, trajtuar më sipër; (ii) kredi e marrë në “Raiffeisen Bank” (overdraft), në shumën 200.000 lekë, ku unë kam tërhequr nga overdraft-i im dhe rezulton debitor në shumën 120.410 lekë, pasi pjesa tjetër është gjendje në llogari, e përfutur nga paga, të cilën e mban banka automatikisht. Shuma e detyrimit të mbetur 120.410 lekë.*

*Në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2015, subjekti ka kryer të njëjtin deklaram si në deklaratën vetting lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, ndërsa në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: Kontratë huaje pa interes me shtetasin N. F., në shumën 20.000 euro, me afat 4 vite, me këst shlyerjeje në shumën 5.000 euro në vit. Kjo hua është marrë për pagesën e kontratës së premtim blerjes së apartamentit në Tiranë. Nuk është shlyer asnjë këst pasi kësti i parë fillon në vitin 2016. Nuk ka filluar shlyerja e kësteve të kontratës.*

**9.8/ç.** Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting, rezulton se si burim krijimi për pagesën e çmimit të apartamentit të deklaruar prej tij në vlerën 50.000 euro, kanë shërbyer:

- të ardhurat nga paga, kursimet e realizuara ndër vite dhe interesat bankarë;
- të ardhurat e sjella nga vëllai nga puna në emigracion;
- huaja në vlerën 20.000 euro, marrë pa interes nga z. N. F..

Kolegji çmon se pavarësisht faktit se një pjesë jodomethënëse<sup>15</sup> e depozitave bankare janë krijuar para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë ato kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë objekt shqyrtimi dhe janë deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike vjetore, do të merren në analizë, si dhe do të verifikohet dhe vlerësohet burimi i ligjshëm i krijimit të tyre.

Lidhur me të ardhurat nga paga, kursimet e realizuara ndër vite dhe interesat bankarë, nga verifikimi i llogarive bankare, rezulton se subjekti në datën 18.05.2015, ka tërhequr nga depozita bankare në BKT, shumën 3.061.779 lekë, të cilën pretendon se e ka përdorur për blerjen e kësaj pasurie. Shuma prej 3.061.779 lekësh e ka prejardhjen nga katër shuma të investuara nga subjekti ndër vite, në depozita me afat, konkretisht:

---

<sup>15</sup> Vetëm vlera prej 200.000 lekësh e depozituar cash në BKT, më datë 29.12.2008.

1. Shuma 510.625 lekë, e krijuar nga një depozitim *cash*, i kryer më datë 11.3.2014, në shumën 500.000 lekë.
2. Shuma 1.031.290 lekë, e krijuar përkatësisht nga: a) shuma 350.000 lekë, e depozituar *cash* në BKT, më datë 28.03.2011, me prejardhje nga shuma 2.200 euro, e deklaruar nga subjekti, me burim nga kursimet e punës së vëllait të tij në Greqi, z. P. S., sjellë në vitin 2006; b) shuma 641.600 lekë, e depozituar *cash* në BKT, më datë 07.06.2013, e cila e ka prejardhjen nga shuma 525.380 lekë, e deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2010, me burim të ardhurat nga emigracioni në Greqi i vëllait të tij, z. P. S..
3. Shuma 619.864,76 lekë është krijuar nga shuma 200.000 lekë, e depozituar *cash* në BKT, më datë 29.12.2008, deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2010, me burim nga paga si jurist në Bashkinë e Peshkopisë, si dhe shuma 300.000 lekë, depozituar *cash* në BKT, më datë 31.12.2012.
4. Shuma 900.000 lekë e depozituar *cash* në BKT, më datë 09.02.2015.

Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, i kryer në Kolegj, ashtu si dhe për Komisionin, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e depozitave ndër vite, të përdorura si burim për financimin e pasurisë apartament, konkretisht:

- Për depozitim e shumës 500.000 lekë deri më datë 11.03.2014, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 439.960 lekë.

- Për depozitim e shumës 350.000 lekë, më datë 28.03.2011, si dhe depozitim e shumës 641.600 lekë, datë 07.06.2013, të cilat kanë si burim të ardhurat nga emigracioni i vëllait të tij në Greqi, z. P. S., rezulton të jetë në mungesë të burimeve të ligjshme, duke qenë se të ardhurat e personit tjetër të lidhur nuk janë provuar se janë krijuar me burime të ligjshme në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

- Për depozitim e shumës 200.000 lekë në vitin 2008, ka rezultuar se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 499.919 lekë.

- Për depozitim e shumës 900.000 lekë deri më datë 09.02.2015, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 609.004 lekë.

Pas analizës së të gjitha depozitave të krijuara deri më datë 18.05.2015, ka rezultuar se nga totali i shumës prej 3.061.779 lekësh (të cilën subjekti i rivlerësimit e ka tërhequr dhe e ka përdorur për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi), shuma prej 2.397.527 lekësh nuk justifikohet si e krijuar me të ardhura të ligjshme dhe, si e tillë, nuk është konsideruar në analizën financiare.

**9.8/d.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në vitin 2008, ka pasur mundësi për të kursyer dhe për të krijuar depozitim e shumës prej 200.000 lekësh, pasi në atë periudhë ka punuar si jurist në Bashkinë Dibër (tetor 2007 - tetor 2008), është trajtuar me bursë pasi ka qenë student në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2008 - tetor 2010), si dhe ka qenë pjesë e familjes bujqësore bashkë me prindërit dhe vëllezërit e tij, duke përfituar të ardhura bujqësore, Kolegji analizoi dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja dhe atë të dorëzuar në Komision<sup>16</sup>, nga i cili rezultoi se subjekti ka paraqitur: (i) 3 (tri) certifikata pronësie në emër të babait të tij A. S.; vërtetim nga ISSH Dibër, datë 19.05.2021, në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore si të vetëpunësuar në bujqësi, për babain për vitet 2013, 2014 dhe 2015

<sup>16</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dorëzuar dokumentacion shoqërues.

dhe për nënën për vitet 2015 deri 2020; (ii) librezë kontributesh të sigurimeve shoqërore, nga e cila rezulton se babai i subjektit ka paguar në vazhdimësi sigurime shoqërore si “fermer privat”, nga 01.01.1993 deri 31.12.2015, dhe nëna ka paguar në vazhdimësi sigurime shoqërore si “fermer privat”, nga data 01.01.1993 deri më 31.12.2020; (iii) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 21.05.2021, lëshuar nga administratori i Njësisë Administrative {\*\*\*}, Bashkia Dibër, në të cilin vërtetohet fakti se z. A. S. ka në pronësi/përdorim 6.156 m<sup>2</sup> tokë bujqësore dhe ka aktivitet bujqësor dhe blegtoral; (iv) vërtetim, datë 19.05.2021, i kryeplakut të fshatit {\*\*\*}, {\*\*\*}/Dibër, në të cilin vërtetohet fakti se prindërit e subjektit kanë tokat e tyre bujqësore të cilat i kanë mbjellë për përdorim familjar me kultura të ndryshme bujqësore, si dhe me pemë frutore.

**9.8/dh.** Kolegji konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore, subjekti nuk ka deklaruar si burim krijimi të depozitave bankare, të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore, këtë pretendim e ka ngritur vetëm gjatë hetimit administrativ në Komision. Lidhur me dokumentet e sipërcituara, Kolegji vëren se pavarësisht se ato mund të konfirmojnë se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë në pronësi tokë bujqësore, janë të vetëpunësuar në bujqësi, si dhe kanë mbjellë produkte bujqësore, nuk arrijnë të provojnë të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore, aq më shumë ligjshmërinë e tyre në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të krijojnë besueshmëri për deklarimin e vonuar të subjektit rreth përdorimit të tyre si burim për krijimin e depozitave objekt kontrolli.

**9.8/e.** Pretendimin e subjektit se në ligjin për ndihmën ekonomike (pa cituar apo specifikuar cili ligj), parashikohet se të ardhurat që familja përfiton nga të afërm të tjerë të ndodhur jashtë Shqipërisë, do të konsiderohen të ardhura, Kolegji e vlerëson të pabazuar pasi, ndonëse subjekti nuk e ka specifikuar ligjin të cilit i referohet, nga një verifikim i legjislacionit në këtë fushë rezulton se ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, në pikën 13 të nenit 4 të tij shprehet se: “*Të ardhura të familjes” kuptohen të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes, nga çdo lloj burimi, duke përfshirë dhe ata që përkohësisht jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit [...]*”, parashikim i cili konsiderohet pa relevancë në kuptim të analizës së të ardhurave të familjes që subjekti synon të provojë për efekt të këtij procesi. Subjekti i rivlerësimit në mënyrë të pasaktë i referohet këtij ligji, i cili ka për qëllim të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike. Kolegji thekson se baza ligjore mbi të cilën kryhet procesi i rivlerësimit të subjekteve, është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe ligji nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit duhet të provojë me dokumentacion përfitimin e të ardhurave, si dhe ligjshmërinë e tyre.

**9.8/ë.** Në “Deklaratën para fillimit të detyrës” në vitin 2010, por edhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka deklaruar se si burim të krijimit të depozitave, kanë shërbyer të ardhurat nga puna e vëllait të tij P. S. si emigrant në Greqi. Pas shqyrtimit të akteve të ndodhura në fashikujt e përcjellë nga Komisioni, Kolegji konstaton se subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor në mënyrë që të vërtetojë punësimin apo përfitimin e ndonjë të ardhure të vëllait të tij, gjithashtu subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka pohuar se vëllai i tij është emigrant ilegal dhe, për rrjedhojë, e ka të pamundur të sigurojë dokumentacion shkresor lidhur me të ardhurat e përfituara.

Në këtë kuptim, shumat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të sjella nga vëllai i tij P. S. nga puna në emigracion në Greqi, të cilat më pas kanë shërbyer për krijimin e depozitave bankare, nuk përmbushin kriterin e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përfshihen në analizën financiare si të ardhura të ligjshme.

#### **9.9. Lidhur me burimin tjetër të krijimit të pasurisë, të ardhurat e sjella nga vëllai nga puna në emigracion në Angli, rezulton se:**

**9.9/a.** Në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2015, subjekti ka deklaruar të ardhura të sjella nga vëllai P. S. në Angli, në vlerën 402.301 lekë<sup>17</sup> dhe 6.545 euro<sup>18</sup>, si dhe shumën 904 (nëntëqind e katër) euro, dërguar më datë 08.02.2015, dërguar nga djali i hallës së tij A. N., dërguar këto shuma nëpërmjet agjencive financiare Money Gram dhe Western Union.

Në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura të sjella nga vëllai P. S. në Angli, në vlerën 1.279.013 lekë, dërguar nëpërmjet agjencive financiare.

Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se si burim për blerjen e kësaj pasurie, kanë shërbyer edhe të ardhurat e sjella nga puna e vëllait P. S. në Angli, si dhe gjatë kohës që ka qenë emigrant ilegal në Greqi.

Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se këto shuma parash të dërguara nëpërmjet agjencive financiare Western Union dhe Money Gram, i janë dhuruar nga vëllai i tij për blerjen e apartamentit dhe për të blerë ndonjë pajisje për mobilimin e shtëpisë, pasi në atë vit nuk i kishte mundësitë financiare për të blerë një apartament të tillë. Subjekti ka depozituar edhe mandatet e transfertave<sup>19</sup>.

Në pyetësin nr. 2, i pyetur në lidhje me dokumentacionin që vërteton të ardhurat e ligjshme të vëllait P. S. nga Anglia, subjekti ka deklaruar se vëllai i tij ka shkuar si emigrant ilegal në Angli në muajin gusht të vitit 2014 dhe ka qëndruar atje deri në muajin prill të vitit 2017, ka shkuar sërish në gusht të vitit 2017 dhe është kthyer në dhjetor të vitit 2019. Sipas subjektit, vëllai i tij ka punuar në sektorin e ndërtimit, por nuk kishte leje qëndrimi, për këtë arsye ka përdorur dokumentet e punës të një shtetasi tjetër (S. E.), duke paguar të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit të shtetit anglez.

---

<sup>17</sup> Transferuar më datë 23.12.2015.

<sup>18</sup> Transferuar më datë 15.03.2015, shuma 1.078 euro; më datë 29.04.2015, shuma 1.616 euro; më datë 13.05.2015, shuma 1.597 euro; më datë 08.06.2015, shuma 2.254 euro.

<sup>19</sup> Mandat tërheqje, datë 29.04.2015, në shumën 1.616,60 euro, dërgues P. S.; mandat tërheqje, datë 13.5.2015, në shumën 1.597,82 euro, dërgues P. S.; mandat tërheqje, datë 8.6.2015, në shumën 2.254,6 euro, dërgues P. S.; mandat tërheqje, datë 23.12.2015, në shumën 402.301,33 lekë, dërgues P. S.; mandat tërheqje, datë 5.3.2016, në shumën 51.180,60 lekë, dërgues P. S., nga Anglia; mandat tërheqje, datë 30.4.2016, në shumën 85.709,19 lekë, dërgues P. S., nga Anglia; mandat tërheqje, datë 31.5.2016, në shumën 43.076,04 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje, datë 25.6.2016, në shumën 654.820,35 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje, datë 3.8.2016, në shumën 169.712,89 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje, datë 12.9.2016, në shumën 167.947,17 lekë, dërgues P. S., nga Anglia; mandat tërheqje, datë 23.12.2016, në shumën 105.939,07 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje, datë 23.1.2017, në shumën 112.098,19 lekë, dërgues P. S., nga Anglia; mandat tërheqje, datë 8.2.2015, në shumën 904,06 euro, dërgues A. N., nga Anglia; mandat tërheqje, datë 15.3.2015, në shumën 1.078,93 euro, dërgues P. S., nga Anglia.

**9.9/b.** Me qëllim vërtetimin e pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar në Komision një *e-mail* të datës 07.06.2021, të dërguar nga kompania {\*\*\*} LTD, në përgjigje të *e-mail*-it të dërguar nga subjekti, në të cilin administratori i saj, z. T. M., shprehet se: *P. S. ka punuar në këtë kompani për periudhën shtator 2014 - dhjetor 2019, në pozicionin e mbikëqyrësit të ndërtimit, me letrat e punës së shtetasit S. E., duke qenë se shteti anglez e lejon një veprim të tillë, për aq kohë sa punonjësi është i siguar.* Në vijim të *e-mail*-it, z. M. pohon se gjatë kësaj periudhe janë paguar të gjitha taksat dhe sigurimet sipas ligjit anglez. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar gjithashtu kopje të dokumentit të identitetit të shtetasit me emrin S. E., disa foto të vëllait të tij duke punuar në një kantier ndërtimi, si dhe kopje të transfertave bankare, në të cilën shtetasi me emrin S. E. ka dërguar pagesa në llogari të bashkëshortes së vëllait të tij.

**9.9/c.** Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit për të ardhurat e sjella nga vëllai i tij P. S., Kolegji vëren se vetëm deklarimi i tyre në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike të viteve 2015, 2016, është i pamjaftueshëm për t'i përmbushur kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Pretendimi i subjektit se këto të ardhura duhet të konsiderohen të ligjshme për shkak se janë përfituar nga i vëllai në emër të një shtetasi të siguar, nuk vlerësohet si një fakt që gjen mbështetje në ligj lidhur me ligjshmërinë e krijimit të tyre. Pavarësisht konsiderimit të vështirësive të përshtatjes e krijimit të mundësive të punësimit në emigracion, versioni i burimit të krijimit të këtyre të ardhurave vlerësohet si të paktën një formë e paparashikuar nga ligji dhe, në këto kushte, e pamundur të arrijë standardin e provueshmërisë së krijimit të tyre e aq më tepër të ligjshmërisë së tyre sipas parashikimeve kushtetuese e ligjore për efekt të këtij procesi. Gjithashtu, edhe dërgimi i këtyre të ardhurave të pretenduara nëpërmjet agjencive financiare nga vëllai i subjektit, por në emër të individëve të tjerë, nuk krijon bindjen se këto transferta i përkasin pikërisht personit tjetër të lidhur dhe për më tepër nuk kontribuojnë në provimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si të dhuruara. Për rrjedhojë, Kolegji vlerësoi se të ardhurat e sjella nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 123,3 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, nuk mund të përfshihen në analizën financiare.

#### **9.10. Lidhur me huanë e marrë nga z. N. F., në shumën 20.000 euro**

**9.10/a.** Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, por edhe në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2015 e ka deklaruar këtë hua në shumën 20.000 euro, me afat 4-vjeçar dhe këst shlyerjeje 5.000 euro në vit. Z. N. F., me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 25.5.2015, ka konfirmuar dhënien e huasë në shumën 20.000 euro, subjektit, me qëllim blerjen e apartamentit. Sipas kësaj deklarate, afati i kësaj huaje është 4-vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit deri më 20.5.2019, me këste prej 5.000 eurosh/vit, të cilat do të kalojnë në llogarinë bankare të huadhënësit.

**9.10/b.** Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni është kontradiktor në qëndrimet e tij pasi huanë e marrë nga z. N. F., në shumën prej 20.000 (njëzet mijë) eurosh, megjithëse e konsideron si të ardhur nga një burim i ligjshëm, nuk e njeh këtë shumë si burim për pagimin e kësteve të çmimit të apartamentit.



**9.10/c.** Lidhur me këtë pretendim të subjektit, Kolegji, pas kontrollit të analizës financiare të Komisionit, konstatoi se Komisioni e ka përfshirë në analizën e tij financiare huanë e marrë nga z. F. si të ardhur të ligjshme, ndërsa për shlyerjen e këstit 5.000 euro nga subjekti në vitin 2016, ka vlerësuar se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për ta shlyer atë me burime të ligjshme, duke qenë se viti 2016 rezultoi të jetë me balancë negative. Në këto kushte, pretendimi i subjektit për vlerësim të gabuar e kontradiktor të Komisionit rezultoi të jetë i pabazuar.

**9.11.** Lidhur me pretendimin e subjektit se shpenzimet e jetesës kanë qenë të papërfillshme pasi deri në shtator të vitit 2016, ka jetuar me prindërit dhe vëllezërit e tij dhe shpenzimet janë paguar nga ata, mbetet vetëm në nivel deklarativ dhe i paprovuar, duke marrë në konsideratë edhe faktin se në certifikatën familjare rezultoi se subjekti është ndarë nga trangu familjar në vitin 2009.

Ndërsa pretendimi i subjektit të rivlerësimit se llogaritja e shpenzimeve për jetesë nga Komisioni, është absurde pasi i ka llogaritur ato në shumën 393.251 lekë për vitin 2016, ndërsa për vitin 2017, në vlerën 940.368 lekë, është i pabazuar. Kolegji, pasi rillogarit shpenzimet e jetesës përkatësisht për vitet përkatëse, i rezultoi se për llogaritja e kryer nga Komisioni është e drejtë, pasi vlera prej 393.251 lekësh i përket periudhës deri më datë 08.06.2015, dhe jo të gjithë vitit kalendarik, siç pretendon subjekti.

10. Sa më lart arsyetuar, nga analiza e të dhënave që vijnë nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, rezultoi se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për financimin e çmimit të këtij apartamenti prej 90.000 eurosh. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë se vëllai i tij P. S., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar shumat e dhuruara. Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë për llogaritur në krijimin e depozitave bankare, të përdorura nga subjekti si burim për financimin e pasurisë së apartamentit, si dhe përballimin e shpenzimeve të tjera, në zbatim të detyrimit të parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën faktike që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
11. Kolegji kontrolloi analizën financiare për subjektin e rivlerësimit të kryer në Komision për periudhën 2010-2016 dhe konfirmon balancën negative të dalë prej saj, në vlerën 7.320.920 lekë, rezultat i cili përcaktohet në pjesën më të rëndësishme prej mungesës së burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë së apartamentit, të analizuar më lart, situatë që gjithashtu kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
12. Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur në këtë mënyrë në një prej rasteve të parashikuara për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për pasojë, vendimi nr. 425, datë 21.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, objekt kontrolli, është i mbështetur në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

## **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 425, datë 21.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Smaçi.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 09.11.2023.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**MIMOZA TASI**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*